

VENDIM
Nr. 142, datë 21.3.1997

PËR RUAJTJEN FIZIKE TË DISA PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE.

Në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, me qëllim që të sigurohet paprekshmëria e personaliteteve të larta shtetërore, me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Garda e Republikës (dega e ruajtjes së personaliteteve të marrë në ruajtje, për periudhën e gjendjes së jashtëzakonshëm, gjithë anëtarët e Qeverisë së Pajtimit Kombëtar, Prokurorin e Përgjithshëm, kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, kryetarin e Gjykatës së Kasacionit, kryetarin e SHIK-ut dhe kryetarin e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Brendshme.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino